



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN: "GREEN COAST HOTEL, 1, 2, 3, 4, 5, 6 KATE
MBITOKË DHE 1 KAT NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË, ME
SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË "GREEN COAST" SH.P.K."

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.

Z. EDIRAMA

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 24, Datë 14.12.2022

Projektues:

51N4E
IRI shpk

iRI

51N4E

TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së
 - 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
 - 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
 - 4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
 - 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave



iRI

51N4E

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1. Baza Ligjore

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Zhvillimit për objektin: "GREEN COAST HOTEL, 1, 2, 3, 4, 5, 6 KATE MBITOKË DHE 1 KAT NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË "GREEN COAST" SH.P.K." bazuar në:

- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar nenit 7 dhe neni 28.
- Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim Nr. 2 datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit.



1.2. Përshkrim i zonës së studiuar

Vendndodhja e objektit është në luginën e Palasës, e pozicionuar në bregdetin e Jonit.

Objekti ndodhet 50 km në jug të Vlorës, 74 km në veri të Sarandës & rrëth 210 km larg kryeqytetit të Tiranës. Objekti është pjesë e Bashkisë së Himarës dhe ndodhet 13 km nga Himara, pjesë e Qarkut të Vlorës, Shqipëri. Objekti ndodhet 109 km larg Korfuzit, Greqi dhe 306 km nga porti i Barit, Itali.

Palasa ndodhet pranë Parkut kombëtar Llogara dhe buzë bregdetit Jon në Rivieren Shqiptare.

Vetë pozicionimi i këtij gjiri bregdetar e bën të pamundur mosmarrjen e vëmendjes në momentin e zbritjes së rrugës nga Parku Kombetar i Llogarase (1200m) mbi nivelin e detit.

I gjithë bregdeti është një kombinim i natyres me detin, duke patur mundësinë të jetë një habitat perfekt për lloj të ndryshme bimësie të cilat karakterizohen nga kodra të mbuluara me pemë ullinj, qitrosh dhe lisash. Së fundmi ky bregdet akomodon dhe funksione turistike apo rezorte banimi.

Të gjitha llojet kryesore të transportit (përveç transportit ajror) janë të përfaqësuar në qarkun e Vlorës, i cili shfrytëzon një stacion hekurudhor (hekurudhat shqiptare), autostradën SH8 e cila kalon qytetin dhe një nga portet më të mëdha në Shqipëri: Porti i Vlorës. Nëse vazhdon rrugët në autostradën SH8, vendndodhja e objektit gjendet më pak se një orë larg me makinë.

Zona në afërsi të ngushtë të vendndodhjes së objektit aktualisht është e pazhvilluar dhe e papopulluar. Aktualisht nuk ka asnjë zhvillim brenda ose rrëth zonës, dhe për rrjedhojë nuk ka ndotje akustike apo ndotje të ajrit. Plazhet e virgjëra të papopulluara dhe aksesi i lehtë do të sjellin propozime unike për shitjen e objektit.





Trualli dhe projekti gëzojnë vizibilitet të shkëlqyer, falë pozicionimit të tij buzë plazhit dhe shpatit të terrenit. Trualli i tokës dhe projekti mund të shihen nga maja e Llogarasë, si dhe nga autostrada SH8 në Parkun e Llogarasë.

Sipas njohurive, nuk ka ndërtime në rrethinat e afërtë, të cilat janë të planifikuara ose që mund të ndalojnë vazhdimësinë e ndërtimit të ardhshëm. Vendndodhja e projekteve kufizohet nga Parku Kombëtar i Llogarasë në veri, i cili është i mbushur me pisha unike dhe gjallesa të egra, në një lartësi prej 2000 m mbi nivelin e detit.

Në hartën e mëposhtme me të kuqe është shënuar pozicionimi i këtij objekti në raport me hapësirat e tjera rezidenciale si dhe bregdetin.



Fig. 1. Vendndodhja e pronës

iRI

51 NATE

2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

2.1. Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së


Duke u bazuar në rregulloren e Planin e përgjithshëm vendor të bashkisë Himarë , të miratuar pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, me nr. Vendimi 2, datë 16.10.2017, "Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor bashkia Himarë", për zonën e interesit HI.UB.1.1232, janë vlerësuar dhe respektuar të gjitha kategoritë e përdorimit të tokës që propozon plani.

Në rastet kur propozimi për zhvillim, pozicionimi i strukturave në territor dhe projekti arkitektonik i tyre vlerësohet direkt në Këshillin Kombëtar të Territorit apo nga Bashkia e Himarës me konkurs të hapur ndërkombëtar, për stimulimin e një lloji të caktuar zhvillimi, atëhere këto struktura dhe parcelat në funksion të tyre përjashtohen nga llogaritja e treguesve të zhvillimit për njësinë përkatëse si dhe nga kushtet e planifikimit të parashikuara sipas neneve 48 deri 57 të kësaj rregullore të kushteve të distancave sipas nenit 52 të kësaj rregullore, në respektim të nenit 35 të "Rregullores së Zhvillimit të Territorit", miratuar me VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar.



2.2. Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

Më poshtë paraqiten të gjitha hartat nga plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Himarë, në të cilat ndodhet propozimi i "GREEN COAST HOTEL, 1, 2, 3, 4, 5, 6 KATE MBITOKË DHE 1 KAT NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË "GREEN COAST" SH.P.K.", prezantuar në dosierin e projektit bashkëlidhur, do të jetë funksional, dhe në përpunje me kërkosat e zhvillimit të zones në të ardhmen.



iRI

51N4E




Fig. 2. Harta e propozuar e kategorive të përdorimit të tokës




Fig. 3. Harta e propozuar e rrjetit rrugor




Fig. 4. Harta e vizionit strategjik



Fig. 5. Harta e njësive strukturore



51 NKE

3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese

Prona e objektit ndodhet në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë, midis Dhërmiut dhe Llogarasë. Sipërfaqja e zonës përreth përbëhet nga truall i lirë toke me ngritje të ulëta të reliefit dhe dendësi të bimësishë lokale që kufizojnë pronën në anën lindore, perëndimore dhe veriore, ndërsa plazhi i Palasës në anën jugore. Rruga kryesore ndodhet në anën lindore

Objekti i propozuar do të shtrihet në afersi të bregdetit pranë kompleksit rezidencial Green Coast. Qëllimi i këtij pozicionimi është distanca dhe njëkohësisht dhe aksesi i lehtë me pjesën e plazhit si dhe afërsia me natyrën.

Me anë të vizitave në terren është parë gjendja ekzistuese e cila momentalisht karakterizohet nga një skarpare e cila krijon një mur pa carje për fasade, mbi te cilen zhvillohet kompleksi rezidencial Green Coast.

Kjo fasade murale bën të mundur një diferencim tepër të sforcuar midis kompleksit rezidencial dhe bregdetit me aktivitetet që marrin pjesë në këtë hapësirë ,e cila krijon një bllok vizual në momentin e pamjes nga bregdeti.

Kjo fasadë murale është e pagjelberuar, ndryshim që tërheq mjaft vëmendje në momentin e kahasimit me pjesët e tjera rreth e rrötull të cilat janë të mbizotruara nga natyra vendase.

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1. Funksionet dhe aktivitetet e propozuara




Fig. 6. Skema e objektit ne altimetri




Fig. 7. Skema e perdonimit ne katin perdhe



Objekti është i përbërë nga tre pjesë kryesore të cilat ndahen në: Malaparte, Capri, dhe Belvedere. Eshtë i shpërndarë në lartësi të ndryshme katesh duke arritur maksimumin në lartësinë e 6 kateve mbi tokë dhe 1 katë nëntokë. Në varësi të kateve bëhet dhe shpërndarja e funksioneve. Objekti është një ndërthurje e strukturës me gjelbërim, duke u integruar me hapësirën përrth. Objekti karakterizohet nga carje të formave dhe madhësive të ndryshme të cilat herë shpërndahen në mënyrë thuajse rastësore nëpër fasadë e herë ndjekin një rregull të përcaktuar.

Në katin e nëntokës gjendet dhoma e valixheve, hapësirat e parkimit të mjeteve Buggy. Në po të njëtin kat gjendet dhomat e sigurisë, kuzhinat, dhomat frigoriferike, dhomat e stafit të restorantit, tualete dhe hapësira ndërrimi.

Në katin përdhe gjendet recepsioni, hapësira e pritjes, hapësira administrative, dhoma mbledhjeje me hapësirë të vogël, dhoma shërbimi, dhoma të tipologjive të ndryshme dhe në pjesën e jashtme gjendjen pishina dhe hapësirë për aktivitete të tjera përrth.

Në katin e parë ndodhet një recepcion i vogël, një qender biznesi, një dhome mbledhjeje, dhoma shërbimi, zyra për administratën dhe hapësirat e SPA-së dhe dhoma të tipologjive të ndryshme.

Në katin e tretë gjenden hapësira si një klub i cili është per persona VIP; dhoma shërbimi si dhe dhoma të tipologjive të ndryshme.

Kati i katërt përbëhet nga hapësira dhe programe si dhoma të tipologjive të ndryshme si dhe dhoma shërbimi për dhomat që akomodohen në këtë kat.

Në katin e fundit kemi funksione si: dhoma shërbimi, tualete dhe dhoma elite dhe dhoma me fushë-pamje panoramike.



Fig. 8. Skema e perdonimit ne katin e pare

4.2. Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave

Volumetria

Ky hotel imiton natyrën përreth tij. Forma e tij ndjek shkëmbin pas hotelit. Objekti është i përbërë nga tre pjesë kryesore përkatësisht: Malaparte; Capri; Belvedere. Është konceptuar në nivele të ndryshme lartësie, duke u tkurrur gradualisht në lartësi dhe arrin maksimumi gjashtë kate mbi tokë me një nën tokë pée parkimin. Nivelet dhe lartësitë e ndryshme ndërthuren në harmoni me sfondin.

Funksionaliteti akordohet në varësi të konfigurimit të niveleve të lartësisë. Hoteli ka formë të pastra e të qarta. Objekti do të jetë një kombinim i gjelbërimit me integrimin e natyrës në sfond.

Fasada

Projekti karakterizohet nga hapje të formave dhe madhësive të ndryshme të cilat hera – herës shpërndahen në mënyrë të rastësishme përgjatë fasadës dhe nganjëherë ndjekin një model. Të gjitha dhomat do të kenë pamje nga deti.

Kombinimi i kujdeshshmëri i materialeve veshëse shoqeruar me kompozimin e kujdeshshëm në trajtimin e fasadave, krijon një imazh pozitiv dhe më të perceptueshem të godinës në kontekstin e gjëre urban të këtij territori. Cilesia e materialeve të përdorura është e larte po kështu edhe kualiteti i sistemeve elektrike, hidraulike apo elektrike.

iRI

51 NAME

Front Facade / Fasada ballore



Back Facade / Fasada e pasme



Fig. 9. Fasadat e objektit



Inkuadrimi në situatën urbane

Konceptimi i formës së objektit është zhvilluar duke marrë në konsideratë reliefin dhe gjendjen ekzistuese të terrenit, duke iu përshtatur lëvizjeve topografike momentale.

Realizohet një lidhje e ngushtë midis terrenit rrethues dhe morfolojisë së objektit. Një pike e rëndësishme e përcaktimit të kësaj shtrirjeje dhe morfologjje është edhe mosperceptimi i këtij objekti nga vilat e kompleksit rezidencial, për arsyen mosbllokimi pamjeje.




Fig. 10. Pamje e objektit të propozuar

5INAE

iRI




Fig. 11. Pamje e objektit të propozuar

iRI

51 NAE



Fig. 12. Pamje e objektit të propozuar



4.3. Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit

TREGUESIT E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT

1. Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	8774 m ²
2. Sipërfaqe e truallit që përdoret për zhvillim:	8774 m ²
3. Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	3517.09 m ²
4. Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë:	16378.75 m ²
5. Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbitokë:	12629.69 m ²
6. Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nëntokë:	3749.06 m ²
7. Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	40 %
8. Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike:	60 %
9. Intensiteti i ndërtimit:	1.44
10. Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	23 m
11. Numri i kateve mbi tokë:	6 kat
12. Numri i kateve nën tokë:	1 kat

TREGUES TEKNIK:

Zona Kadastrale: Z.K. 1739; Nr. pasurie 68/137/2, 5212/7/1, 68/121/1

Distancat nga kufiri i pronës:

Veriu 0m – 20.6m, Lindja 0.61m – 4.64m, Jugu 6.36m -21.91m, Perëndimi 1.90-11.71m.

Distancat nga aksi i rrugës: Lindje 351.8m.

Zhvillues:

Green Coast shpk

51NATE
JF

iRI

Subjekt Ndërtues: Green Coast shpk

4.4. Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet

Si pjesë e hapësirës së Parkut të Liqenit, objekti është i rrrethuar nga hapësira të gjelberuara. Raporti i hapësirës se lirë në krasim me hapësirën e zënë nga ndërtimi është 58%. Hapësirat rreth e përqark objektit, janë brenda normave për garantimin e një qarkullimi normal të këmbësorëve dhe për të siguruar akses në raste emergjencash. Ato gjithashtu janë menduar që të jenë njëkohësisht dhe të gjelbërtë mjaftueshëm për t'u përdorur si hapësira çlodhëse, tipike për hapësira te tilla urbane. Parkimet janë tërësisht nëntokësore.

5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

5.1. Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

Ky projekt nuk prezanton asnjë ndryshim apo propozim të ri për infrastrukturën rrugore. Respektton plotësisht gjendjen ekzistuese, dhe propozimin e planit të ri të bashkisë Himarë, për sa i përket, rrjetit të infrastrukturës rrugore që ka zona e interest; të cilat protësohen dhe nga rruga e re me infrastrukturën përkatese e përcaktuar nga Plani i Pergjithshem Vendor faza 1.




Fig. 13. Planvendosja e strukturës që propozohet